



Prishtinë, 10.07.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1172_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 10.4 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derrogimeve të Kodit të Rrjetit, të datës 12.06.2019 dhe të reviduar me 09.07.2019 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT),

në seancën e mbajtur me datë 10.07.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për **Derrogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, të OST** si në arsyetimin dhe shtojcën e këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbesin në fuqi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 12.06.2019 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derrogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit të OST.
- KOSTT në dokumentin e dërguar për derrogim ka sqaruar arsyet për mos përmbushjen e obligimeve dhe kërkesës për derrogim të dispozitave ligjore të **Kodit të Rrjetit**:

- **Kodi operativ,**

***Stabiliteti dhe Mbingarkesa e Rrjetit – Meqenëse linja 110 kV nr. 1809 NS Prizren
2 – NS Rahovec është radiale, deri në përfundimin e ndërtimit të linjës NS Rahovec***



– NS Therandë kriteri N-1 nuk plotësohet.

Kërkesa deri më **31.12.2019** është aprovuar;

- **Kodi i Balancit,**

dispeçimi në kushtet e pamjaftueshmërisë së furnizimit - mospërputhja e ngarkesës me gjenerimin në kohë real - Kërkohej derroqim vetëm për pjesën e veriut të Kosovës, për shkak se çështja e furnizimit të veriut ende nuk është zgjidhur.

- kërkesa deri më **31.12.2019** është aprovuar;


Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës sipas Raportit të Derrogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit e ka parë si të arsyeshme kërkesën e KOSTT për derroqim, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfi, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Bushiti, anëtar

Vendimi së bashku me Raportin e derrogimeve me afatet e lejuara iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.